




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr. 556/2023
Datë: 27 dhjetor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe 33 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 2 të Rregullores Nr. 07/2017 për Organizimin dhe Funksonimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, në vazhdimin e takimit 318-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Rekomandimi i Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës lidhur me ri-funksionalizimin e Shoqatës së Gjyqtarëve, të zbatohet përmes komunikimit të Sekretarit të Asamblesë;
- II. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të mbështet me logjistikë kërkesat e Asamblesë në procesin e ri-funksionalizimit dhe pas funksionalizimit të Shoqatës.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka shqyrtuar rekomandimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, nga takimi i datës 12 dhjetor 2023, për ri-funksionalizimin e Shoqatës së Gjyqtarëve, e cila është regjistruar në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, e cila po ashtu ka të miratuar edhe Statutin e Shoqatës.

Shoqata e Gjyqtarëve ka funksionuar deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve të saj, por që më pas nuk janë zhvilluar aktivitete tjera, lidhur me përzgjedhjen e kryesisë së Shoqatës apo rizgjedhjes së tyre, siç parashihet në Statutin e Shoqatës, si pasojë e mungesës së hapësirave përkatëse, përkatësisht zyrave për zhvillimin e veprimtarisë së Shoqatës.

KGJK, pas diskutimit dhe shyrimit të Rekomandimit të Asamblesë, me qëllim që të shmang çfarëdo influence, ka vlerësuar që ky rekomandim të zbatohet në atë mënyrë që komunikimi me gjyqtarët të zhvillohet përmes Sekretarit të Asamblesë, duke pranuar edhe kërkesat për mbështetje logjistike.

Nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;*
- *Sekretarit të Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;*
- *Sekretariatit të KGJK-së;*
- *Arkivit.*